



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.292/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti, dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtuar kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

- I. **PRANOHET E BAZUAR** ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.292 datë 01.02.2025.
- II. Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 4.000,00 Euro (katërmijë) Euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 01/02/2025 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV më të cilën pretendohet se më 1 shkurt 2025, përkundër Vendimit të PZAP Anr. 85/ 2025 të datës 24 janar 2025 përmes të cilit, vendosjen e postereve/banereve të kandidateve për deputetë nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës - PDK në hapësirat/rrugët publike të Prishtinës i ka vendosur dhe vlerësuar si në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë kanë identifikuar sot (më 1 shkurt 2025) se banerët/posterët e vendosura në hapësirat e njëjta publike/rrugët publike të kandidateve të shumtë të PDK-së për deputetë, vazhdojnë të jenë të jenë aktive të postuara në hapësirat publike.

Rrjedhimisht, PZAP me Vendimin Anr. 87/2025 të datës 24 janar 2025, kishte përfshirë dhe kishte trajtuar ankesat si në vijim: Anr. 87/2025, Anr. 110/2025, Anr. 111/2025, Anr. 112/2025, Anr. 113/2025 dhe Anr. 114/2025) ndaj kandidatëve për deputetë nga radhët e PDK-së si: Bedri Hamza, Eliza Hoxha, Bernard Nikaj, Memli Krasniqi, Mimoza Ahmetaj, Ilirik Musliu, Pleurat Sejdiu, Ferat Shala, Ariana Musliu Shoshi, Vlora Çitaku, Uran Ismaili si dhe kandidatë të tjerë, të cilët në hapësirat e ndryshme publike në rrugët si: "Nënë Tereza", "Fehmi Lladrovci", Bulevardi "Dëshmoret e Kombit", "Idriz Seferi", "Luan Haradinaj" "Migjeni" e të tjera (siç janë përfshirë në Vendimin Anr. 87/2025 të PZAP) në Prishtinë, kishin vendosur posteret/baneret e tillë.

Me këtë veprim, ndonëse të sanksionuara nga PZAP si veprime të subjektit PDK në kundërshtim me dispozitat e nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP, posterët/banesët e tillë vazhdojnë të jenë të vendosura në këto hapësira përkatëse publike, në kundërshtim me dispozitat e LZPProvë: Fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP Si provë parashtruesi I ankesës ka bashkangjitur: Foto dhe Link i Vendimit të PZAP Anr. 87/2025:

Në përgjigje në ankesë të parashtruar me datë 02.02.2025, subjekti politik PDK përmes kësaj përgjigje, ka kërkuar nga PZAP që ankesën e ankuesit t'a refuzoj si të pabazuar për arsye se: PDK, më datë 25.01.2025, ndaj vendimit A.nr.87/2025, të datës 24 janar 2025, ka parashtruar ankesë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, duke konsideruar se vendimi i kontestuar është rezultat i konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit material. PDK, më datë 01 shkurt 2025 ka pranuar vendimin aktgjykimin AA.nr.23/2025, të Gjykatës Supreme të Kosovës, përmes së cilës ka refuzuar ankesën e subjektit tonë politik, ashtu që ka vërtetuar vendimin A.nr.87/2025. Po ashtu parashtruesi I përgjigjies në ankesë ka theksuar se Partia Demokratike e Kosovës me të pranuar vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, respektivisht më datë 01 shkurt 2025, ka obliguar operatorin ekonomik që të largoj të gjitha posterët/banerët për të cilat është mbajtur përgjegjëse sipas vendimit A.m. 87/2025 të PZAP, e të cilat janë larguar pikërisht në ditën e pranimit të vendimit të Gjykatës Supreme, e datës 01 shkurt 2025. Parashtruesi i përgjigjies në ankesë si provë ka bashkangjitur:Fotografi të hapësirave të cilat janë objekt I kësaj ankesë ku në mënyrë të pakontestueshme vërtetohet fakti se të njëjtat tashmë veqse janë larguar.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :
-Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndëve dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga Subjekti Politik PDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decidive thuhet se *"Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve."*

Në përgjigje në ankesë të Subjektit Politik PDK, se posterët/banerët janë larguar, njëherit ka bashkangjitur si provë dy foto.

Paneli gjatë shqyrtimit të provave gjegjësisht dy fotove se Subjekti Politik PDK i ka larguar posterët/banerët nga hapsirat publike, ka vërejtur se të njëjtat foto, nuk kanë asnjë dëshmi

se në cilën rrugë, adresë janë larguar këta posterë/banerë, dhe nuk e ka dëshmuar me prova se i ka larguar posterët/banerët, njëherit në ankesën e Subjektit Politik Vetëvendosje përmenden adresat ku janë vendosur posterët/banerët nga ana e Subjektit Politik PDK, dhe atë në rrugët “Nëna Terezë”, RR.“Fehmi Lladrovci”, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, “Idriz Seferi”, “Luan Haradinaj”, “Migjeni”, ndërsa Subjekti Politik PDK, nuk e ka kontestuar me përgjigje në ankesë se posterët/banerët, nuk gjinden në adresat e përmendura në ankesë nga ana e subjektit politik Vetëvendosje, dhe nuk ka bashkangjitur prova materiale se e ka obliguar operatorin ekonomik për largimin e posterëve/banerëve.

Paneli ka vlerësuar se vendosja e postereve nga subjekti politik PDK respektivisht kandidatet e këtij subjekti në hapësirat publike, në mungesë të lejes përkatëse të lëshuar nga Komuna e Prishtinës i konsideron si shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, po ashtu edhe në këtë proces zgjedhor. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e posterëve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në hapësira publike gjegjësisht në rrugët publike për të cilat nuk posedojnë Pëlqim nga Komuna e Prishtinës, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën saktësisht e sanksionuar me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Me rastin e vendosjes për lartësin e gjobës paneli vlerësoi si rrethanë lehtësuese, se subjekti politik PDK, ka bërë përpjekje të arsyeshme për ta evituar shkeljen – heqjen e disa posterë/banerë nga hapësirat publike.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.292/2025 datë 03.02.2025



Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa bazuar në nenin 118 paragrafi 4 të LZP-së.